



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 22.07.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 19.07.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AsTech" për aktivitetin: "FURNIZIMI DHE MIREMBAJTJA E KONDICIONEREVE NE OBJEKTIN E KOMUNES DHE INSTITUCIONET TJERA KOMUNALE" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-4043--121 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "As Tech" e datës 19.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit " FURNIZIMI DHE MIREMBAJTJA E KONDICIONEREVE NE OBJEKTIN E KOMUNES DHE INSTITUCIONET TJERA KOMUNALE" me Nr.616 19 4043 121,Nr. kundër *Njoftimit te Vendimit te AK-se për dhenje te kontrates të aktivitetit*, të datës 16.07.2019, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e dhenjes se kontrates i publikuar me datë: 16.07.2019;**
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "AS tech" me datë 16.07.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "FURNIZIMI DHE MIREMBAJTJA E KONDICIONEREVE NE OBJEKTIN E KOMUNES DHE INSTITUCIONET TJERA KOMUNALE" me Nr.616 19 4043 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 19.07.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Pretendimi se kontrata e nënshkruar me datën 12.10.2016 ka qenë kontratë për 36 muaj ndërsa referenca i është leshuar në tetor 2017 nuk paraqet asnjë argument të ndonjë shkelje ligjore, pasi që kontrata kornizë përmbyllet ose me skadimin e afatit ose me përbushjen e saj në vlerën plus 30% siqë ka ndodhur në këto raste. Lidhur me këto dhe pretendimin e njëjtit në

piken vijuese se nje reference qe eshte leshuar para afatit te parapare te kontrates prej 36 muaj nuk eshte e vlefshme ju preferojme ti referoheni tekstit te Nenit 38 te LPP-ik pika 1 ku percaktohet si vijon:

1. Asnjë kontratë publike kornizë nuk do të ketë kohëzgjatje më shumë se 36 muaj. Kontrata publike kornizë nuk mund të zgjatet apo të ri-përtërihet dhe kushtet e saj nuk mund të ndryshohen. Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë derivim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

Pra nga kjo eshte e qarte se tejkalimi i vleres prej plus 30% automatikisht nenkupton permbylljen, respektivisht nderprerjen e te njejtës.

-Pretendimi tjetër se nga e njejta kontrate e dates 12.10.2016 jane kryer sherbime ne vitin 2018 eshte poashtu plotesisht e pasakte dhe e pa bazuar, pasi qe sherbimet ne vitin 2018 jane kryer sipas nje kontrate me vlere minimale prej 954.00 euro e poashtu edhe kontrata ne vlere prej 9,665.00 euro e dates 16.02.2016 eshte kontrate e veçante dhe nuk ka te bej me kontraten qe pretendoni ju.

Poashtu me duhet t'iu sqaroj se sipas kontrates kornize te dates 12.10.2016 jane kryer eshe sherbimet shtese prej 30%, te cilat nuik jane paraqitur ne oferten e tenderuesit te propozuar per kontrate. Por duke mos marre parasysh sherbimet shtese prej 30% e per te cilat nuk jane kerkuar sqarime ju sqaroj se tenderuesi i propozuar per kontrate ka deshmi vetem per furnizime te njejtë (e jo te ngjajshme) ne vleren prej 54,784.45 euro dhe me kete e ploteson kekesen e Autoritetit Kontraktues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë ka vendosur si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit